

Në cilën gjuhë të flitet me fëmijën?

Edukimi në shumë gjuhë

A jeni menduar ndonjëherë vallë se, a është e drejtë nëse Ju me fëmijën Tuaj komunikoni në gjuhën Tuaj, në të cilën mund të shprehni më së miri dhe të ndjeheni më mirë? Dhe lidhur me këtë, a Ju ka vrarë ndonjëherë ndërgjegjja, kur në fshehtësi keni menduar, se ja, me fëmijën Tuaj duhet të flisni gjermanisht, për arsye se ai në shkollë doemos duhet të mësojë gjermanisht? E pikërisht për këtë arsye, me fëmijën Tuaj mbase edhe flisni gjermanisht?

Ne logopedistët punojmë me fëmijët që kanë vështirësi për ta përvetësuar gjuhën. Kur një fëmijë ka probleme lidhur me komunikimin në gjuhën e vet amtare, kjo do të thotë se ai ka pengesa në të folur, gjë që e parandalonjë atë ta përvetësojë gjuhën në përputhje me moshën.

Fëmija i shëndoshë, i cili gjuhën e tij të parë e ka mësuar me bazë, është në gjendje që paralelisht apo njërën pas tjetrës të mësojë dy e më shumë gjuhë. Është tejet e rëndësishme pra, që Ju si prindër, me fëmijën Tuaj të flisni, të bëni shaka, ta qortoni, të hidhëroheni apo edhe të gëzoheni - në gjuhën Tuaj. Për ta përvetësuar gjuhën duhet të respektohen rregullat e poshtëshënuara:

- Bisedoni me fëmijën Tuaj, pa marrë parasysh se çka jeni duke bërë në atë rast – jeni duke përgatitur gjellën apo duke rregulluar diçka në shtëpi. Gjuha, pa marrë parasysh se cila, mund të mësohet vetëm nga përvoja. Tentimi për të komunikuar në një gjuhë të caktuar kur duam të tregojmë diçka, ta dëgjojmë dikë apo të gëzohemi, është parakusht i rëndësishëm për ta përvetësuar atë.
- Bisedoni me fëmijën Tuaj vetëm në gjuhën amtare, sipas motos: „Një person – një gjuhë“ Në qoftë se keni vendosur që me fëmijën Tuaj të komunikoni në një gjuhë të caktuar, kësaj duhet t'i përmbaheni në mënyrë konsekuente! Pra mos i përziëni gjuhët! Mund të ndodhë që fëmija Juaj papritmas të fillojë të flasë gjuhën e mjedisit, por Ju edhe më tej dhe qetë vazhdoni të flisni me të vetëm në gjuhën amtare!
- Mundohuni t'i shmangeni përzjerjes së gjuhëve!
Në fillim fëmijët e vegjël shpesh i përziejnë gjuhët që fliten në një mjedis të caktuar. Por Ju vetë duhet të jeni konsekuent në përdorimin e gjuhës Suaj. Me këtë i ndihmoni fëmijës Tuaj që ai të mësojë t'i dallojë gjuhët e ndryshme.
- Po qe se fëmija Juaj duhet t'i mësojë dy gjuhë, atëherë ai do të ketë nevojë për nxitje pozitive për të dyja gjuhët! Është e preferueshme që me fëmijën Tuaj të shikoni librat me ilustrime, t'i lexoni atij tregime, të bisedoni me të për përjetimet e tuaja, t'ia thirrni shokët në shtëpi – dhe kjo do të ishte mënyra më e mirë për ta nxitur atë që ta mësojë gjuhën – pa marrë parasysh se cilën gjuhë! Manifestoni një qëndrim pozitiv për dygjuhësinë e fëmijës Tuaj!

Dihet mirëfilli se të mësuarit e themeltë të një gjuhe – nuk është e thënë që kjo të jetë gjermanishtja! – do të ndihmonte në zhvillimin e gjithanshëm të fëmijës Suaj. Ai i cili në një gjuhë të caktuar ndjehet mirë dhe sigurt, është në gjendje të përdorë fjalë dhe të komunikojë edhe në ndonjë gjuhë tjetër.

Suksesi i përvetësimit të gjuhës së dytë varet nga shkalla e të mësuarit të gjuhës së parë!

S'do mend se njohja e gjuhëve për çdo kend është një privilegj i madh. Po qe se keni dilema, dëshironi të pyetni apo edhe të dini mos ndoshta fëmija Juaj ka vështirësi serioze për ta përvetësuar gjuhën, atëherë lirisht na telefononi!